

Banka e Shqipërisë

TENDENCAT NË KREDITIM

TREMUJORI I - 2016

ERJONA SULJOTI, SOFIKA NOTE DHE OLTA MANJANI
DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE

PRILL 2016

Pikëpamjet e shprehura në këtë material janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bankës së Shqipërisë.

P Ë R M B A J T J A

<i>PËRMBLEDHJE</i>	<i>5</i>
<i>1. KREDIA PËR BIZNESE</i>	<i>6</i>
<i>2. KREDIA PËR INDIVIDË</i>	<i>9</i>
<i>3. ÇMIMI I KREDISË DHE KUSHTET E TJERA TË KREDITIMIT</i>	<i>12</i>
<i>4. TENDENCAT E KREDITIMIT NË VENDET E RAJONIT</i>	<i>15</i>

Ky material synon të paraqesë një panoramë të zhvillimeve më të fundit të aktivitetit kreditues në vend. Për të përmbushur këtë qëllim, materiali analizon të dhënat monetare për portofolin e kredisë, si dhe kushtet e kreditimit. Gjithashtu, pjesë e këtij materiali është edhe një përmbledhje e zhvillimeve më të fundit të aktivitetit kreditues në vendet e Evropës Qendrore Juglindore (EQJL).

Statistikat kryesore të analizuara në këtë material janë:

- Të dhënat për aktivitetin kreditues të bankave për sektorin rezident të ekonomisë.
- Të dhënat cilësore të marra nga vrojtimi i aktivitetit kreditues.
- Statistikat për çmimin e kredisë si në monedhën vendase, ashtu edhe në euro.
- Të dhënat monetare për vëllimin e kredisë për vendet e rajonit. Vendet e përfshira në analizë janë: Bullgari (BU), Kroaci (Cr), Rumani (RO), Serbi (Sr), Poloni (Pl), Hungari (Hu), Çeki (CZ), Maqedoni (IRJM).

Materiali mbulon të dhënat e publikuara deri më 18 prill 2016, të cilat përshijnë informacion për të dhënat monetare dhe financiare për muajin shkurt 2016 dhe të dhënat e vrojtimit të aktivitetit kreditues për tremujorin e parë të vitit 2016.

PËRMBLEDHJE

Kredia për sektorin privat ka shënuar rritje vjetore prej 2.4% në dy muajt e parë të vitit 2016. Përmirësimi i ritmeve të rritjes në kredinë për biznese ka balancuar ngadalësimin në kredinë për individë. Në zhvillimet sipas monedhave, kreditimi në lekë ka vijuar të rritet me ritme të qëndrueshme, ndërsa kreditimi në valutë ka konfirmuar normat pozitive vjetore të sinjalizuara në fund të vitit të kaluar.

Norma e rritjes së kredisë për biznese është përmirësuar lehtësisht në dy muajt e parë të vitit 2016. Gjithsesi, normat vjetore të rritjes së këtij portofoli mbeten të moderuara, në nivelin 1.6%, duke përcaktuar dobësinë e kreditimit të sektorit privat. Kërkesa e bizneseve për financim mbetet e brishtë, duke pasqyruar hezitimin e bizneseve për të marrë përsipër rrezik dhe praninë e kapaciteteve të lira prodhuese. Nga ana e ofertës, megjithë lehtësimin e kushteve të kreditimit krahasuar me fundin e vitit 2015, ato janë ende të shtrënguara në segmente të caktuara.

Kredia për individë është rritur me ritme më të ngadalta se në fund të vitit 2015. Megjithatë, ky portofol ka dhënë kontributin kryesor në zgjerimin e kredisë për sektorin privat. Zgjerimi vjetor me 4.2% i këtij portofoli, është mbështetur nga kreditimi i individëve për konsum, ndërsa rritja vjetore e kredisë për banesa është shfaqur në nivele të ngjashme me fundin e vitit të kaluar. Bankat kanë vijuar të lehtësojnë kushtet për individët, por ato vlerësojnë se kërkesa nga individët në tremujorin e parë të vitit ka qenë në rënie.


Normat e interesit të kredisë në lekë në muajt janar-shkurt janë lehtësisht më të larta se në tremujorin e fundit të vitit 2015. Ato janë shfaqur të luhatshme dhe vijojnë të ndikohen nga kredi dhe banka të veçanta, në kushtet kur vëllimet e kredisë së re mbeten të ulëta. Në një krahasim më afatgjatë, ato vijojnë të ndjekin trend rënës, ndonëse jo aq të shpejtë sa ai i normave të interesit të depozitave. Sipas klientit, reduktimi i normave të interesit është më i dukshëm tek individët.

Kreditimi i sektorit privat në vendet e rajonit të EQJL-së shfaqet i përmirësuar në dy muajt e parë të vitit 2016. Ky përmirësim është ndikuar pozitivisht nga zgjerimi i kredisë në vendet e Ballkanit, ndërsa për vendet e Evropës Qendrore portofoli i kredisë vijon të rritet me ritme të qëndrueshme. Zgjerimi i kredisë për sektorin privat mbështetet nga ecuria pozitive dhe e qëndrueshme e kredisë për individë, në pjesën më të madhe të ekonomive të rajonit.

1 KREDIA PËR BIZNESE¹

Kredia për biznese ka shfaqur norma të ulëta rritjeje në dy muajt e parë të vitit 2016, duke përcaktuar edhe ecurinë e dobët të portofolit të kredisë për sektorin privat. Ritmet e rritjes vjetore shënuan mesatarisht 1.6%, në përmirësim të lehtë krahasuar me fundin e 2015-ës. Zgjerimi vjetor i portofolit të kredisë së bizneseve është mbështetur nga kredia për investime. Financimi i bizneseve për qëllime investimi është shoqëruar edhe me përmirësimin e kreditimit në valutë të bizneseve. Paralelisht, kredia në lekë për biznese është përmirësuar lehtësisht. Edhe pse standardet e kreditimit për biznese kanë qenë në kahun lehtësues, ato mbeten të shtrenguara dhe kërkesa për financim vazhdon të jetë e dobët. Në tremujorin në vazhdim bankat presin të vazhdojë lehtësimi i kushteve për kredinë për SME-të, ndërkohë që kërkesa pritet të mbetet e ulët.


Kredia për biznese shënoi një rritje vjetore mesatare prej 1.6% për dy muajt e parë të vitit 2016. Portofoli i kredisë për biznese është tkurrur me 1 miliard lekë krahasuar me fundin e dhjetorit, duke reflektuar tkurrjen e portofolit të kredisë dhënë për financimin e nevojave për likuiditet të bizneseve. Tkurrja e kredisë për likuiditete, për vetë maturitetin afatshkurtër të saj, ka qenë në linjë me sezonalitetin e dobët të fillimvitit. Krahasuar me një vit më parë kredia për likuiditete ishte mesatarisht 0.7% më e lartë. Ndërkohë, kreditimi në lekë i lidhur më shumë me financimin e bizneseve për nevoja likuiditeti shfaqet i luhatshëm. Norma vjetore e kredisë në lekë për biznese është përshpejtuar në janar për t'u ngadalësuar në shkurt, duke shënuar një normë mesatare prej 3.2% për këta dy muaj krahasuar me 2.4% në tremujorin e katërt 2015.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

¹ Të dhënat e kredisë për biznese përjashtojnë efektin e kredive të nxjerra nga bilanci. Gjatë dy muajve të parë të vitit 2016, niveli i kredive të nxjerra jashtë bilancit për bizneset ka qenë rreth 1.3 miliardë lekë.

Zgjerimi i portofolit të kredisë për biznese në muajt janar-shkurt është mbështetur nga rritja e financimit për qëllime investimi. Rritja vjetore e këtij portofoli me mesatarisht 2.6% qëndroi pranë nivelit mesatar të vitit 2015. Ecuria pozitive e këtij segmenti të kredisë, që prej gjashtëmuajorit të dytë të vitit 2015, është shoqëruar edhe me rritjen e kreditimit në valutë për biznese. Gjatë dy muajve të parë të vitit kreditimi në valutë është zgjeruar me 0.8%, në përmirësim të lehtë nga norma e rritjes në tremujorin e katërt të vitit 2015.



Paralelisht me këto zhvillime, kredia e re nuk sinjalizon për rigjallërim të vazhdueshëm të kredisë për biznese (ose pikë kthese në ecurinë e portofolit të kredisë). Për dy muajt e parë të vitit ajo është 14.6% më e ulët se një vit më parë për të njëjtën periudhë, duke konfirmuar praninë e një kërkesë të dobët për financim nga bizneset, veçanërisht nga biznesi i madh, i cili dominon



portofolin e kredisë. Në krahasim me një vit më parë, rënia e kredisë së re

ka reflektuar tkurrjen e kredisë së dhënë për nevoja likuiditeti. Pavarësisht se bankat kanë konfirmuar lehtësimin e kushteve të kreditimit për bizneset, në linjë dhe me pritjet që ato kishin, kërkesa e bizneseve mbetet e luhatshme dhe e dobët. Kjo ecuri është e kushtëzuar nga shfrytëzimi jo i plotë i kapaciteteve prodhuese dhe hezitimi i bizneseve për të marrë përsipër rrezik. Po kështu, edhe burimet alternative të financimit jashtë sektorit bankar kanë vijuar të përbëjnë një faktor të rëndësishëm për kërkesën e ulët për financim në banka.


Për tremujorin e ardhshëm, bankat presin të lehtësojnë kushtet vetëm për financimin e biznesit të vogël dhe të mesëm. Ky është segmenti që ato e shohin me përparësi për t'u zgjeruar, si për shkak të shumave të vogla të kreditimit me të cilat ato ekspozohen, ashtu edhe për balancimin e portofolit të kredisë. Këto biznese janë më shumë të përfshira në sektorin e agrobujqësisë, i cili është një nga sektorët e ekonomisë që së fundi ka shfaqur kërkesë të shtuar për financim nga bankat. Bankat pohojnë se ato gjenden më afër biznesit të vogël dhe të mesëm, duke ofruar produkte që i përshtaten nevojave të këtij grup biznesi. Prandaj ato presin një përmirësim të kërkesës nga segmenti i SME-ve për tremujorin e ardhshëm. Ndërkohë, situata e mirë e likuiditetit të bankave, konkurrenca midis tyre dhe politika monetare kanë qenë faktorët kryesorë për lehtësimin e standardeve.

Kushtet e kreditimit për bizneset e mëdha priten të shtrëngohen në tremujorin e dytë të vitit. Faktorët kryesorë që ndikojnë në shtrëngimin e standardeve të kreditimit për ta mbeten situata e pafavorshme makroekonomike dhe rreziku i lartë i kreditimit, që lidhet si me nivelin e huave me probleme, ashtu edhe me probleme specifike në sektorë të caktuar. Në tremujorin e dytë të vitit 2016, bankat presin njëkohësisht edhe rënie të kërkesës për kredi nga bizneset e mëdha. Po kështu, kërkesë më e ulët pritet edhe për kredinë për financimin e nevojave për likuiditet dhe për atë për investime.

2. KREDIA PËR INDIVIDË²

Zhvillimet pozitive në kredinë për sektorin privat janë mbështetur në mënyrë të qëndrueshme nga ecuria e mirë e portofolit të kredisë për individë. Edhe në tremujorin e parë të vitit, ky portofol ka shfaqur rritje vjetore me 4.2%, normë kjo e ngadalësuar në krahasim me fundin e vitit 2015. Kredia konsumatore, pavarësisht peshës së vogël, ka qenë kontribuuesi kryesor në ritmet e rritjes së kredisë për individë. Ndërkohë, kredia për banesa ka mbetur në nivelet e fundvitit 2015. Ecuria e mirë e portofolit të kredisë për individë është mbështetur edhe nga lehtësimi prej disa vitesh i kushteve të kreditimit për këtë segment, i cili ka vazhduar edhe në tremujorin e parë të vitit. Megjithatë, bankat pohojnë se kërkesa nga ky segment ka qenë në rënie, por pritet të rritet në tremujorin pasardhës.


Ritmi i rritjes së kredisë për individë në dy muajt e parë të vitit është ngadalësuar në mesatarisht 4.2% krahasuar me 4.6% në tremujorin e fundit të vitit 2015. Ky ngadalësim, më së shumti, paraqet efektin statistikor të rritjes së këtij portofoli në fillim të vitit 2015, ndërkohë që kredia për këtë segment gjatë gjithë pjesës së dytë të vitit është rritur me ritme të njëtrajtshme. Në dy muajt e parë të vitit kjo ecuri është mbështetur më shumë nga kredia konsumatore, e cila shënoi një rritje vjetore mesatare prej 12.4% në këta dy muaj përkundrejt rritjes prej 9.6% në tremujorin e katërt të 2015-ës. Pavarësisht përshejtimit të rritjes së këtij portofoli, pesha e tij e vogël prej 26%, nuk ka balancuar tkurrjen



² Të dhënat e kredisë për individë përjashtojnë efektin e kredive të nxjerra nga bilanci. Kreditë e nxjerra jashtë bilanci për individët në dy muajt e parë të vitit shënuan rreth 0.2 miliardë lekë.

e portofolit të kredisë për qëllime aktiviteti³. Ndërkohë, rritja vjetore e portofolit të kredisë për banesa shënoi 3.1%, e ngjashme me rritjen vjetore në tremujorin e katërt të vitit 2015.

Kreditimi i individëve sipas monedhës tregon se ecuria pozitive e këtij portofoli mbështetet nga kreditimi në lekë. Kredia në lekë për individë është rritur me mesatarisht 8.7%, duke kontribuar plotësisht në rritjen vjetore të portofolit dhe ka balancuar rënien e lehtë të kredisë në valutë. Gjatë vitit 2015 e në vazhdim, politikat e shumë bankave në sistem kanë qenë të orientuara drejt këtij segmenti të kredisë duke prezantuar produkte, si për kredinë konsumatore, ashtu edhe atë hipotekare në lekë, me kushte favorizuese dhe të padiferencuara nga kreditë në euro. Marketingu i këtyre produkteve dhe afrimi më i madh i individëve në banka si pagamarrës ka ndihmuar në zgjerimin e kreditimit të individëve në lekë. Krahas këtyre faktorëve, edhe vetë individët janë ndërgjegjësuar më shumë për rrezikun e kursit që ka kreditimi në valutë. Në shkurt 2016, kredia në lekë ndaj totalit të kredisë për individë përbën 53.3% ose 2.2 pikë përqindje më lartë se një vit më parë. Zhvillimet në kredinë e disbursuar për individët tregojnë se kjo kredi në 2 muajt e parë të vitit është 3.6% më e lartë se një vit më parë. Kjo rritje ka reflektuar rritjen e kredisë së dhënë për nevoja konsumi, e cila ka kompensuar edhe reduktimin e kredisë së re për banesa.




Ecuria pozitive e kreditimit për individë duket se është përkrahur nga kushtet e kreditimit nga bankat, të cilat kanë më shumë se dy vjet që lehtësohen. Sipas rezultateve të vrojtimit të aktivitetit kreditues, lehtësimi i kushteve të kredisë për individë është mbështetur nga ecuria e mirë e likuiditetit të bankave, konkurrenca në sistemin bankar, si dhe lehtësimi i kushteve monetare në vend. Ndërkohë, gjendja financiare e individëve dhe kreditë me probleme janë faktorët kryesorë për politikat konservatore të bankave ndaj individëve⁴.

³ Ky zë gjatë vitit 2015 është ndikuar nga saktësime të raportimit të bankave për këtë kategori, duke e riklasifikuar një pjesë të tij si kredi për biznese.

⁴ Referuar rezultateve të vrojtimit të aktivitetit kreditues http://www.bankofalbania.org/web/Vrojtimi_i_aktivitetit_kreditues_5311_1.php

Grafik 6. Standardet dhe kërkesa e kredisë për individë sipas qëllimit të përdorimit*




*Në grafik të dhënat paraqesin indeksin e balancës neto kumulative nga tremujori i katërt 2009 për standardet e kreditimit dhe kërkesën sipas qëllimit të përdorimit.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pavarësisht lehtësimit të kushteve të kreditimit, bankat vlerësojnë se kërkesa për kredi nga individët ka rënë në tremujorin e parë të vitit, si pasojë e besimit të përkeqësuar konsumator dhe zhvillimeve në tregun e pasurive të paluajtshme. Për tremujorin e dytë të vitit, bankat presin lehtësim të mëtejshëm të kushteve të kreditimit dhe rritje të kërkesës në segmentin e individëve.

3. ÇMIMI I KREDISË DHE KUSHTET E TJERA TË KREDITIMIT

Normat e interesit të kredisë në muajt janar-shkurt janë lehtësisht më të larta se në tremujorin e fundit të vitit. Ato janë shfaqur të luhatshme dhe vijojnë të ndikohen nga kredi të veçanta, në kushtet kur vëllimet e kredisë së re mbeten të ulëta. Në një krahasim më afatgjatë, ato vijojnë të ndjekin trend rënës, ndonëse jo aq të shpejtë sa ai i normave të interesit të depozitave. Sipas klientit, reduktimi i normave të interesit është më i dukshëm tek individët. Marzhet e ndërmjetësimit janë rritur në dy muajt e parë, por mbeten pranë mesatareve të viteve të fundit. Kushtet joçmim të kreditimit kanë qenë kryesisht në kahun lehtësues, si për individët, ashtu edhe për bizneset.


Normat e interesit të kredisë në lekë kanë pësuar rritje në muajt janar-shkurt. Norma mesatare e tyre rezultoi 7.91%, nga 7.68% që shënonte në tremujorin e katërt të vitit të kaluar. Kjo rritje i dedikohet kryesisht normave të larta për disa kredi për biznese të dhëna në dy muajt e parë të vitit. Pavarësisht luhatjeve afatshkurtra të tyre, normat e interesit për kreditë në lekë kanë ndjekur përgjithësisht një trajektore rënëse, në ndjekje të politikës monetare lehtësuese të zbatuar nga Banka e Shqipërisë. Kështu, çmimi mesatar i kredisë në lekë në dy muajt e parë të vitit është rreth 0.23 pikë përqindje më i ulët se një vit më parë dhe 0.66 pikë përqindje më i ulët se para dy vitesh.



Përcjellja e politikës monetare lehtësuese ka qenë më e shpejtë dhe më e plotë në normat e interesit të depozitave, ndihmuar edhe nga likuiditeti i bollshëm në ekonomi. Në dy muajt e parë të vitit, norma mesatare e interesit të depozitave në lekë ra më tej, në nivelin 1.25%. Marzhi i ndërmjetësimit


u rrit kundrejt tremujorit të fundit të vitit të kaluar, në 6.7 pikë përqindje, por gjithsesi ai mbetet në nivele të ngjashme me ato mesatare të vërejtura në 3 vitet e fundit.

Ecuria e normave të interesit për kreditë në lekë ka qenë e ndryshme për bizneset dhe individët. Tek bizneset vërehet një rritje e normave të interesit në tremujorin e parë, kryesisht si pasojë e normave më të larta për kredinë për investime. Duke përjashtuar disa kredi me norma jotipike të dhëna këtë periudhë, normat për biznese kanë mbetur të krahasueshme me nivelin e tremujorit të katërt 2015. Nga ana tjetër, individët kanë përfituar nga reduktime të vazhdueshme të çmimit të kredisë, për të gjitha llojet e saj. Normat e interesit të kredisë në lekë për individë u janë afruar normave të interesit të kredive për biznese, të cilat historikisht kanë qenë më të ulëta. Në dy muajt e parë të vitit, vërehet vetëm një rritje e lehtë e normave të interesit për kreditë *overdraft* në krahasim me tremujorin e fundit të vitit të kaluar.



Normat e interesit për kreditë në euro në fillim të vitit kanë ecur në mënyrë të ngjashme me ato në lekë. Norma mesatare e interesit ka rënë për individët, e nxitur nga reduktimi i normave të interesit për kredinë hipotekare dhe për financimin e konsumit afatgjatë. Ndërkohë, ajo rezulton e rritur për bizneset krahasuar me fundin e vitit të kaluar, por kjo rritje reflekton nivele veçanërisht të ulëta të normave të interesit në tremujorin e fundit të vitit të kaluar. Duke mënjanuar këtë efekt, normat e interesit për kreditë në euro për bizneset janë gjithashtu në rënie. Në krahasim me një vit më parë, çmimi i kredisë në euro ka rënë, si për individët, ashtu edhe për bizneset. Nga ana tjetër, normat e interesit të depozitave në euro kanë zbritur në nivele të ulëta historike, prej mesatarisht 0.27% në janar dhe shkurt. Për rrjedhojë, marzhi i ndërmjetësimit në euro rezulton i rritur kundrejt tremujorit të fundit të vitit të kaluar, në 5.22 pikë përqindje. Kundrejt një viti më parë, ai është rreth 0.75 pikë përqindje më i ulët.

Grafik 9. Ecuria e kushteve jointeres të kreditimit për bizneset (majtas) dhe individët (djathtas), në pikë përqindje*



*Shënim: balancat pozitive/negative nënkuptojnë lehtësim/shtrëngim të kushteve.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në tremujorin e parë të vitit, bankat kanë raportuar lehtësim të kushteve të përgjithshme të kreditimit, si për bizneset, ashtu edhe për individët. Ndër kushtet jointeres të aplikuara për kreditë për biznese, vërehet ulja e komisioneve dhe rritja e madhësisë së kredisë së akorduar si faktorë që kanë ndikuar në lehtësimin e standardeve për bizneset. Ndërkohë, kërkesat për kolateral dhe maturitetin e kredisë kanë ndikuar në kahun shtrëngues të kushteve të kreditimit për bizneset.

Politika e bankave për lehtësimin e kushteve të kreditimit të individëve vazhdon prej disa tremujorësh. Krahas uljes së normës së interesit, bankat raportojnë për ulje të komisioneve, rritje të madhësisë së kredisë, si dhe zgjatje të maturitetit të saj për individët. Ndërkohë, gjatë këtij tremujori, rritja e marzhit për kreditë me rrezik, rritja e kërkesave për kolateral dhe ulja e raportit këst/të ardhura kanë ndikuar kahun shtrëngues të kushteve të kreditimit të individëve.

4. TENDENCAT E KREDITIMIT NË VENDET E RAJONIT


Aktiviteti kreditues i sektorit privat⁵ në vendet e rajonit të EQJL-së ka shfaqur shenja përmirësimi që nga tremujori i katërt i vitit 2015. Kjo sjellje është më e dukshme në rajonin e Ballkanit, ku normat vjetore të kredisë për sektorin privat kanë kaluar në territor pozitiv. Ndërkohë, kreditimi në rajonin e Evropës Qendrore ka vijuar të shfaqet me rritje të qëndrueshme, duke shënuar norma mbi mesataren e vendeve të tjera. Zgjerimi i kredisë për sektorin privat vijon të udhëhiqet në një masë të gjerë nga kredia për individë.

Kreditimi i sektorit privat në vendet e rajonit në dy muajt e parë të vitit shfaqet i përmirësuar kundrejt një tremujori më parë. Kjo rritje vijon të jetë relativisht e segmentuar në terma gjeografikë. Rajoni i Evropës Qendrore vazhdon të udhëheqë këtë rritje, me rreth 5% mesatarisht në terma vjetorë. Normat e rritjes vjetore të kreditimit në rajonin e Ballkanit, prej rreth 2% mesatarisht, shfaqin një prirje për t'u përafëruar me ato të vendeve të Evropës Qendrore në muajt e fundit. Në vrojtimet e aktivitetit kreditues në vendet e EQJL-së⁶, bankat kanë raportuar pesë herë radhazi për rritje të kërkesës për kredi nga agjentët ekonomikë. Vrojtimi i fundit i muajit nëntor ka konfirmuar gjithashtu pritjet e bankave për rritje të mëtejshme të kërkesës, si edhe të ofertës, në gjashtë muajt e ardhshëm. Këto pritje duket të jenë materializuar gjatë muajve të parë të vitit 2016, periudhë në të cilën kredia për sektorin privat ka vijuar të rritet me ritme të qëndrueshme në rajonin e Evropës Qendrore, me përjashtim të Hungarisë. Gjithashtu, pas një pike kthese në muajin nëntor, kredia për sektorin privat në vendet e rajonit të Ballkanit ka hyrë në territor pozitiv, duke shënuar norma rritjeje edhe për dy muajt e parë të vitit 2016. Megjithatë, rritja në këtë rajon është e përqendruar kryesisht në vende si Rumania dhe Maqedonia. Ndërkohë, ulja e përdorimit të levës financiare në raport me PBB-në duket të jetë thelluar për disa nga vendet e rajonit të Ballkanit. Në rajonin e Evropës Qendrore, Hungaria rezulton me rënien më të madhe të këtij raporti, ndërsa Polonia dhe Çekia evidentohen si vende me prirje në rritje të përdorimit të levës financiare.

⁵ Kredia për vendet e rajonit të EQJL-së dhe për Shqipërinë analizohet në terma realë, duke përjashtuar efektin e kursit të këmbimit dhe të inflacionit.

⁶ Për më shumë referoju materialit: http://www.eib.org/attachments/efs/economics_cesee_bls_2015_h2_en.pdf


Grafik 10. Kredia për sektorin privat në vendet e rajonit: ecuri vjetore dhe raport ndaj PBB-së



Burimi: Banka e Shqipërisë, bankat qendrore, FMN -ja dhe llogaritje të autorëve.

Ecuria e kredisë sipas agjentëve ekonomikë evidenton norma të përmirësuar të rritjes së kredisë për biznese në dy muajt e parë të vitit, me rreth 3% mesatarisht. Zgjerimi i këtij portofoli mbështetet kryesisht nga vendet e rajonit të Evropës Qendrore, si Polonia dhe Çekia. Në rastin e Hungarisë, portofoli i kredisë për biznese, sikurse dhe ai për individë, vazhdon të tkurret. Zgjerimi i stokut të kredisë për biznese kushtëzohet gjithashtu nga ecuria e plogësht e tij në rajonin e Ballkanit, ku shumica e këtyre vendeve vijon të mbetet në territor negativ. Megjithatë, në vrojtimin e fundit të aktivitetit kreditues në vendet e EQJL-së në muajin nëntor, të gjithë faktorët që ndikojnë kërkesën raportohen me kontribut pozitiv. Nevojat për kapital qarkullues, investime dhe ristrukturim borxhi janë të gjithë faktorë që perceptohen me ndikim pozitiv edhe në gjashtë muajt e ardhshëm, duke ndikuar në moderimin e normave të tkurrjes së portofolit të kredisë për biznese në fund të vitit të kaluar dhe dy muajt e parë të vitit 2016.

Grafik 11. Kreditimi i bizneseve në vendet e rajonit



Burimi: Banka e Shqipërisë, bankat qendrore, institucionet statistikore të vendeve përkatëse dhe llogaritje të autorëve.

Portofoli i kredisë për individë ka vijuar të shënojë norma më të larta rritjeje, duke udhëhequr rritjen e kredisë për sektorin privat në rajonin e EQJL-së. Kredia për individë është zgjeruar me rreth 4% në terma mesatarë vjetorë në dy muajt e parë të vitit. Njëkohësisht, ajo ka vijuar të ruajë njëtrajtësinë gjeografike të zgjerimit ndërmjet vendeve të rajonit të EQJL-së. Ndryshe nga periudhat e mëparshme, ku rajoni i Evropës Qendrore shënonte normat më të larta të rritjes për këtë portofol, në muajt e fundit është vënë re gjithashtu një rritje e shpejtë e kredisë për individë edhe në vendet e Ballkanit. Faktorët që kanë ndikuar kërkesën, si për kredinë për blerje banese dhe për kredinë konsumatore, kanë dhënë kontribut pozitiv sipas vrojtimit të fundit në vendet e rajonit. Edhe pritjet për faktorë të tillë si besimi konsumator apo tregu i pasurive të paluajtshme janë perceptuar me ecuri pozitive për gjashtë muajt në vijim, duke materializuar këtë efekt në normat e rritjes së portofolit në muajt e fundit.

Grafik 12. Kreditimi i individëve në vendet e rajonit

